



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

**KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË
DREJTAT E NJERIUT**

Tiranë, më 19.2.2024*(Dokument parlamentar)*

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PROJEKTLIGJ

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 81/2017 “PËR ZONAT E
MBROJTURA”**

➤ ***Hyrje***

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit **për dhënie mendimi** bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen online në platformën “Zoom” të datës 19.2.2024 mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, i propozuar nga një grup prej 12 deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë.

Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin z. Jurgis Çyrbja.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishte i pranishëm një nga nismëtarët e projektligjit, deputeti z. Fadil Nasufi .

➤ ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, vjen si një nisëm e një grup prej 12 deputetësh dhe paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 81 pika 1, 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3, të Rregullores së Kuvendit.

➤ ***Qëllimi, objektivat që synohen të arrihen dhe përmbajtja e projektligjit***

Qëllimi i projektligjit është rregullimin e disa problematikave që vijnë si pasojë e zbatimit të ligjit në terren, kryesisht në bashkëpunimin e qeverisjes vendore, komuniteteve dhe administratës së zonave të mbrojtura.

Ligji aktual nuk përmbush efikasitetin e nevojshëm për të adresuar tensionet dhe konfliktet reale, si ndërthurja e "Zonave me Përparësi Zhvillimi" me "Zonat e Mbrojtura".

Problematikat e identifikuar janë rezultat i mangësive në hartimin e ligjit në vitin 2017, ku një përkufizim strikt i mbrojtjes nuk ka marrë parasysh faktorin komunitar. Me rritjen e zonave të mbrojtura në vitin 2023, duke përfshirë 21.5% të territorit të Shqipërisë, nevojat e komunitetit bëhen thelbësore dhe kërkojnë zgjidhje pa kompromentuar parimet baze të ruajtjes dhe mbrojtjes së tyre.

Qëllimi i projektligjit është evident, theksimi i parimeve dhe politikave të reja për evoluimin e koncepteve të ndërtuara nga organismat ndërkombëtare. Këto ndryshime shfaqen si rezultat i realitetit të ri dhe nevojës për një zhvillim të qëndrueshëm. Ligji propozon koncepte të reja për kategorizimin e biodiversitetit sipas rëndësisë, aktualizimin e tij më të shpeshtë, dhe përfshirjen e qeverisjes lokale dhe komuniteteve në vendimmarrje.

Ruajtja dhe mbrojtja e biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura nuk duhet të jetë ekskluzive, por gjithëpërfshirëse, duke inkorporuar edukimin ambiental. Projektligji synon të adresojë të gjitha problematikat e përmendura nga përfaqësuesit e qeverisjes vendore, duke siguruar një qasje integrale për të zhvilluar një paketë turistike të qëndrueshme dhe inkurajuar zhvillimin ekonomik dhe perspektivat rajonale.

○ *Objektivat që synohen të arrihen janë:*

- ✓ të riformulojë parimet e menaxhimit të zonave të mbrojtura, duke shtuar parimin e përshtatshmërisë, "parimin e kategorizimit të objektivave" dhe "parimin e fleksibilitetit të menaxhimit", me qëllim rritjen e efikasitetit në procesin e menaxhimit të këtyre zonave, duke u bazuar në parimet e IUCN;
- ✓ të riformulojë politikat shtetërore në fushën e zonave të mbrojtura, në kuadër të nevojës për një bashkëpunim/ndërveprim me institucionet e tjera të qeverisjes qendrore, vendore si dhe shoqërinë civile, me qëllim adëimin, ruajtjen dhe mbrojtjen efikase të këtyre zonave;
- ✓ të rishikojë funksionet e institucioneve publike, në kuadër të nevojës për të përforcuar rolin e tyre nëpërmjet bashkëpunimit dhe harmonizimit të punës së përbashkët, me qëllim sigurimin e ruajtjes, mbrojtjes dhe adëimit të zonave të mbrojtura;
- ✓ të garantojë aksesin e publikut në zonat e mbrojtura;
- ✓ të ripërcaktojë llojet e zonave të mbrojtura mjedisore, sipas llojit të interesit për të cilin është marrë statusi i mbrojtjes, duke shtuar edhe kategorinë "zona të mbrojtura me interes lokal/bashkiak, me qëllim lehtësimin e menaxhimit të tyre nga institucionet e qeverisjes vendore;
- ✓ ti mundësojë bashkive të menaxhojnë një pjesë të zonave të mbrojtura, të cilat janë pjesë e territoreve përkatëse që adëojnë;

- ✓ të riformulojë objektivat e shpalljes së territoreve si zona të mbrojtura , me qëllim mbrojtjen e ketyre zonave me anë të rritjes së ndërgjegjësimit, edukimit të publikut, nxitjen për kryerjen e aktiviteteve kërkimore-shkencore, nxitjen për kryerje të aktiviteteve rekreative dhe veprimtarive ekonomike në përputhje me parimin e efektivitetit, por dhe me objektivat e zonës së mbrojtur;
- ✓ të harmonizojë terminologjinë e ligjit me atë të IUCN-së;
- ✓ të riformulojë aktivitetet e lejuara apo të ndaluara në zonën e mbrojtur “Park Kombëtar”.
- ✓ t’u japë mundësinë e zhvillimit të veprimtarive ekonomike banorëve të zonës, me qëllim që të kenë akses e të përfitojnë prej tyre;
- ✓ të lejojë përdorimin e tokës dhe kryerjen e aktiviteteve të cilat zbatojnë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm me fokus zhvillimin ekonomik të zonës;
- ✓ të lejojë ndërhyrjet e lejuara urbane, rekreacionit apo industriale brenda zonës, por duke ruajtur karakterin e saj;
- ✓ të nxisë dhe të përkrahë nisma, projekte, programe dhe veprimtari që synojnë përmirësimin e treguesve ekologjikë e natyrorë të një zone të mbrojtur mjedisore, ose që ndikojnë pozitivisht në to.

○ *Përmbajtja e projektligjit*

Projektligji, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, përbëhet nga 22 nene, të cilat ndryshojnë përmbajtjen e neneve të ligjit bazë me argumentet në vijim:

Neni 1 bënë ndryshim të nenin 4 duke shtuar tre parimeve të rëndësishme si "parimi i përshtatshmërisë" "parimi i kategorizimit të objektivave" dhe "parimi i fleksibilitetit të menaxhimit". Shtimi i këtyre parimeve lind si nevojë për rritje të efikasitetit në procesin e menaxhimit të ketyre zonave duke u bazuar në parimet e IUCN.

Neni 2 shton një nen të ri, nenin 4/1 “Politikat mbi zonat e mbrojtura” si nevojë që ekziston për një bashkëpunim/ndërveprim me institucionet e tjera të qeverisjes qendrore, vendore si dhe shoqërinë civile me qëllim adëimin, ruajtjen dhe mbrojtjen efikase të këtyre zonave.

Neni 3 shton një nen të ri, nenin 4/2 “Funksioni i institucioneve publike”, si nevojë për të përforcuar rolin e institucioneve publike me anë të bashkërendimit dhe harmonizimit e punës së përbashkët me qëllim sigurimin e ruajtjes, mbrojtjes dhe adëimit të zonave të mbrojtura.

Neni 4 shton një nen të ri, nenin 4/3 “Aksesi i publikut në zonat e mbrojtura”, për dhënien e mundësisë së publikut për të patur akses në këto zona përveç rasteve kur niveli i mbrojtjes e pengon. Po ashtu, dhe pronarët dhe poseduesit e zonave të mbrojtura, të cilët duhet të garantojnë ruajtjen e këtyre pronave dhe vlerave të tyre. Kjo vjen edhe si pasojë e mungesës së bashkëpunimit me institucionet e për këtë arsye ky nen është vlerësuar i nevojshëm për tu shtuar.

Neni 5 ndryshon neni 6 duke shtuar dhe "zona të mbrojtura me interes lokal/bashkiak” për shkak se është vakum në ligj dhe parashikimi i tij mund të lehtësojë menaxhimin e këtyre zonave nga institucionet e qeverisjes vendore.

Neni 6 ndryshon nenin 8 duke shtuar një pika 3/1 “3/1. Në çdo rast, Bashkia përkatëse adëon jo më pak se 20% e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura që janë në territorin e kësaj bashkie”, duke i dhënë mundësi bashkive, të menaxhojnë një pjesë të zonave të mbrojtura të cilat janë pjesë e territoreve përkatëse që adëojnë.

Neni 7 ndryshon nenit 9 i cili parashikon objektivat e shpalljes së territoreve si zona të mbrojtura. Ky ndryshim propozohet me qëllim mbrojtjen e këtyre zonave me anë të rritjes së ndërgjegjësimit, edukimit të publikut, nxitjen për kryerjen e aktiviteteve kërkimore-shkencore, nxitjen për kryerje të aktiviteteve rekreative dhe veprimtarive ekonomike në përputhje me parimin e efektivitetit por dhe objektivat e zonës së mbrojtur.

Neni 8 ndryshmon pikeë 6 të nenit 10 në disa elemente të tij si përputhja me terminologjinë e IUCN fjalja "planit kombëtar të rrjetit përfaqësues të këtyre zonave" zëvendësohet me fjalinë "Planit Specifik të Zonave".

-Shkronja "ç" përshtatet duke përfuruar rëndësinë e një raporti të vlerësimit në mjedis, ku përcaktohen veprimtaritë që janë kryer në këto zona të propozuara për tu shpallur që mund të kenë dëmtuar diversitetin e tyre biologjik.

- shtohet shkronja "f" ku parashikohet propozimi për veprimtaritë e lejuara në bashkitë të cilat kanë në adëimin e tyre dhe territore të cilat shpallen apo janë shpallur zona të mbrojtura. Kjo shtesë lind si nevojë e përfshirjes së bashkive dhe popullatës vendase në procesin e menaxhimit të tyre.

Neni 9 shfuqizon nenit 13 të ligjit bazë.

Neni 10 bëhen shtesa të nenit 16 ku përcaktohet qartësisht aktivitetet e lejuara apo të ndaluara në zonën e mbrojtur "Park Kombëtar".

Në pikën "2" gërma "c" shtohet përjashtimi në rastet kur KKT, ëia përgjegjëse apo bashkitë përkatëse evidentojnë se investimi në një zonë të caktuar është i një niveli të rëndësisë Kombëtare dhe ky investim, në të njëjtën kohë, respekton kriteret e mbrojtjes.

Gërma "d" e pikës 2 shfuqizohet

Në piken "3" dhe "4" shtohet dhëia e mundësisë së zhvillimit të veprimtarive ekonomike nga banorët e zonës.Veprimtari të cilat janë në përputhje me kriteret e mbrojtjes si dhe marrin miratim paraprak në bashki. Kjo është një nevojë që lind si pasojë e mospërfshirjes së banorëve që banojnë në këto zona, të kenë akses e të përfitojnë prej tyre.

Neni 11 bënë ndryshim të i pikës 3 të nenit 17 ku shtohet fjalja "..në rastet kur monumenti i natyrës nuk është në zonë të banuar nuk aplikohet përcaktimi i zonës së saj buferike".

Neni 12 bënë ndryshim të nenit 19 duke shtuar pikën 2/1 me qëllim përcaktimin e veprimtarive të parashikuara në nenin 33 të këtij ligji, si dhe propozon shfuqimimin e gërmes "b" të pikës 3.

Ndërsa pika 4 riformulohet për lehtësi leximi dhe kuptueshmërie.

Neni 13 bënë ndryshim të nenit 20 ku, gërma "c" e pikës "3" ndryshon “ Përdorimin e tokës dhe kryerjen e aktiviteteve që zbatojnë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm me fokus zhvilimin ekonomik të zonës.

Në pikën "3" shtohet gërma "e" në përputhje me parimin e efektivitetit dhe planit të menaxhimit të ndërhyrjeve të lejuara urbane, rekreacionit apo industriale brenda zonës duke ruajtur karakterin e zonës sipas parashikimeve të këtij ligji”

Propozohet dhe pika 3/1 "Peizazhin e mbrojtur" ushtrohen veprimtari sipas përcaktimeve të këtij neni, neneve 33 dhe 50 të këtij ligji”. Ky ndryshim propozohet me qëllim nxitjen e zhvillimit të këtyre zonave në bazë të parimit të efektivitetit, por duke respektuar kriteret e tyre të mbrojtjes bazuar në planet përkatese të menaxhimit.

Nenet 14/15/16/17 bëjnë ndryshime të nenet 21/22/23/24 ku në secilën prej tyre shtohet pika 2/1 e cila referon në nenin 33 të ligjit bazë. Ky referim kryhet në funksion të qartësisë së veprimtarive të cilat lejohen të ushtrohen në këto zona.

Neni 18 shton pikën "4" dhe "5" të nenit 33, ku propozohet se AKZM-ja dhe pushteti lokal duhet të nxisin nisma apo veprimtari të cilat kanë efekte pozitive në zonat e mbrojtura. AKZM-ja dhe ADZM- të përkatëse propozohet të hartojnë rregullore të cilat duhet të shpallen në vende të dukshme të zonës. Këto janë ndryshime që vijnë si nevojë e zhvillimit dhe mirëmenaxhimit të zonave të mbrojtura në përputhje me parimin e fleksibilitetit të menaxhimit.

Neni 19 bënë ndryshim të nenit 38 duke shtuar në pikën 5 gërmën “j” me përmbajtje "j. vlerëson dhe i propozon Ministrin përgjegjës për zonat e mbrojtura rishikimin e planit të menaxhimit për zonën apo disa zona të mbrojtura."

Neni 20 bënë ndryshim të nenit 42, pika 3 gërma “f” pas fjalëve “..veprimtari tradicionale” shtohen fjalët “..dhe ekonomike”

Shtohet pika 6 më këtë përmbajtje “6. Plani i menaxhimit në çdo rast, mund të rishikohet me propozim të AKZM-së, apo ADZM-vë përkatëse, sipas procedurave të parashikuara në këtë ligj për miratimin e tij”.

Në nenin 21 bënë ndryshim të nenin "74 Dispozitat kalimtare” duke shtuar pikën 4 me përmbajtje “4. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave, Ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura dhe KKT marrin masa që të reflektojnë ndryshimet e dispozitave të këtij ligji në aktet përkatëse që kanë miratuar në zbatim të këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 22 parashikohet hyrja në fuqi e tij.

➤ ***Vlerësimi i shkallës së përafrimit me Acquis Communautaire***

Projektligji nuk synon përafrimin me ndonjë acquis të BE-së.

➤ ***Institucionet dhe organet që ngarkohen me zbatimin e projektaktit***

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektakti janë Eia përgjegjëse për mjedisin; AKZM dhe ADZM-të dhe Njësitë vetëqerisjes vendore.

➤ ***Efekti Financiar***

Projektligji ka efekte finaciare.

➤ **Diskutimi në komision:**

Gjatë prezantimit të nismës z. Fadil Nasufi u shpreh se ky projektligj ka si qëllim rregullimin e disa problematikave që si pasojë e zbatimit të ligjit në terren kryesisht në bashkëpunimin e qeverisjes vendore, komuniteteve dhe administratës së zonave të mbrojtura. Këto ndryshime vijnë në momente të një pjekurie intelektuale të shoqërisë dhe të vendosjes së rregullave të qarta dhe të përshtatshme për të siguruar që vendi ofron një paketë turistike të larmishme, por edhe të qëndrueshme dhe që komunitetet lokale u ofrohet një mundësi e shkëlqyer zhvillimi, duke krijuar vende pune, ekonomi dhe një perspektive rajonale.

Gjithashtu z. Nasufi shpjegoi procedurën e ndjekur për konsultimin publik me shoqatat dhe grupet e interesit, marrjen e mendimit nga ministria e linjës, si dhe nënvizoi se qëllimi i nismës është përmirësimi i menaxhimit të zonave të mbrojtura, zgjidhja e disa problematikave konkrete në terren që lidhen me informalitetin dhe ndërtimet pa leje që janë kryer përgjatë viteve të tranzicionit brenda zonave të mbrojtura dhe që janë ende të patrajtuara për shkak të paqartësisë ligjore të kompetencave. Gjithashtu parashtroi se me ndryshimet e propozuara kërkojmë të bëjmë një harmonizim midis ligjit për zonat me përparësi zhvillimi, të cilat janë prioritet kombëtare, dhe zonave të mbrojtura, për të shmangur mbivendosjen dhe për të pasur një ecuri paralele mes instrumenteve të planifikimit dhe zhvillimit të planeve vendore dhe ndarjes, apo përcaktimit të zonave të mbrojtura.

Me tej z. Nasufi nënvizoi se duhet të përmirësohet menaxhimi i zonave të mbrojtura, dhe jo vetëm të shtojnë inventarin e zonave të mbrojtura. Pra ky projektligj duhet parë në aspektin e integruar përfshirë sfidat që ka një shtet, si edhe sfidat që sjellin të gjitha hapësirat publike që duhen menaxhuar.

Deputeti z. Jurgis Çyrbja në cilësinë e relatorit vlerësoi rëndësinë e nismës për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe zgjidhjen e disa problematikave në terren të prezantuara nga përfaqësuesit e pushtetit vendor, kryesisht në bashkëpunimin mes pushtetit vendor të zonave të mbrojtura dhe komunitetit, por dhe nxitjen e ekonomisë së qëndrueshme.

Duke vlerësuar se Ndryshimet ligjore të propozuara janë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, z. Çyrbja ftoi kolegët ta miratojnë projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.

Në fjalën e tij deputeti z. Majko vlerësoi iniciativën e deputetëve, por gjithashtu theksoi se është e rëndësishme që strukturat përgjegjëse të qeverisë të shprehen në mënyrë shteruese lidhur me propozimet politikbërëse. Në fund të fjalës së tij propozoi që përfaqësuesit e qeverisë të japin shpjegime të qarta lidhur me ndryshimet e propozuara në projektligj.

Kryetarja e Komisionit znj. Bushka në fjalën e saj parashtroi se Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 56, datë 7.2.2024, ka miratuar opinionin lidhur projektligjin e propozuar nga 12 deputet dhe ka sjell një mendim shterues të konsultuar me ministritë e tjera të linjës dhe me

autoritet publike si dhe specifikisht Ministria e turizmit dhe mjedisit si ministri përgjegjës për zbatimin e këtij projektligji, ka dhënë propozimet e veta për disa amendamente të cilat janë të detyrueshme për tu marrë në konsideratë nga Kuvendi të cilat do të duhen të diskutohen dhe vlerësohen nga Komisionin përgjegjës.

Më tej, znj Bushka u shpreh se ne si Komision për dhënie mendimi duke rënë dakort me z. Majko që kjo është një çështje e politikëbërjes që do të duhet ta kemi në konsideratë duke qënë se ne shohim anën e përpunueshmërinë e projektligjit me Kushtetutën dhe ligjet e tjera në fuqi, pra pa i hyrë thelbit të nismës pasi është komisioni përgjegjës që do të duhet patjetër të marrë në konsideratë mendimin e Këshillit të Ministrave dhe specifikisht atë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si ministri përgjegjës për zbatimin e projektligjit ka informuar se në kuadër të dhënies së mendimit për nismën e propozuar ka zhvilluar takime me organizata jo fitimprurëse që operojnë në fushën e mjedisit dhe zonave të mbrojtura për të çmuar opinionin e tyre lidhur me draftin e përcjellë, si dhe me agjenci shtetërore të zbatimit të legjislationit të zonave të mbrojtura, si Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe Agjencinë Kombëtare të Zhvillimit të Territorit, duke vlerësuar shqetësimin e Kuvendit dhe të qeverisjes vendore në raport me zonat e mbrojtura.

Pra, gjithashtu të përfshirë në procesin e shtimit të zonave të mbrojtura si një prioritet i Qeverisë Shqiptare për të përmbushur angazhimet ndërkombëtare botërore të 30% të sipërfaqes së vendit brenda vitit 2030, por dhe në angazhimin e jashtëzakonshëm të shpalljes Park Kombëtar të lumit të fundit të egër në Evropë, Vjosës nevoja për të përditësuar legjislationin e zonave të mbrojtura me elementë të administrimit, ruajtjes, mbrojtjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm është një domosdoshmëri në kuadër të planit të menaxhimit kombëtar të lumit Vjosë në bashkëpunim me partner ndërkombëtar prestigjioz si Patagonia, Unioni Ndërkombëtar, etj. Një grup ekspertësh ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar kanë depozituar raporte për paqarësi dhe kundërshtime lidhur me ligjin në fuqi për zonat e mbrojtura si dhe kanë sygjyer ndërhyrje ligjore për t'iu përshtatur zonave të mbrojtura në Shqipëri.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit vlerëson se arsyetimet e mësipërme të marra së bashku janë argumenta të plota për të kërkuar një rishikim të pjesshëm të kuadrit ligjor në fuqi për zonat e mbrojtura. Megjithatë nuk është dakort me një pjesë të propozimeve të depozituar të cilat sipas mendimit të ekspertëve të saj çënojnë qëllimin e mbrojtjes të ruajtjes së vlerave të zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit.

Gjithashtu komisioni përgjegjës ka zhvilluar degjese me grupet e interesit, për të cilat duhet të jetë i kujdesshëm në shqyrtimin e të gjitha mendimeve të ardhura nga shoqëria civile.

Në vijim të diskutimeve znj. Bushka u shpreh se kemi një nismën deputetësh, vendimin e Këshillit të Ministrave dhe një seri dëgjësash të cilat duhet të merren parasysh nga komisioni përgjegjës për të siguruar një tekst projektligji të përshtatshëm duke adresuar në mënyrën e duhur të gjitha kërkesat për këtë qasje konstruktive për të riformuluar nene dhe për të arritur

qëllim, pra ekuilibrin midis mbrojtjes së mjedisit me interesave e zhvillimit të vendit duke ju referuar edhe standarteve me të mira ndërkombëtare.

Pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut kanë ardhur dy shkresa nga grupet e intersit, të cilat do ti paraqiten Komisionit përgjegjës për ti marrë në shqyrtim të cilat janë:

- Shoqata Omitologjike e Shqipërisë, e cila kërkon domosdoshmërinë e kalimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” për shqyrtim në Komisionin për Çështjet Europiane;
- Shoqata “Albanian Renewable Energy Association” (AREA), e cila propozon ndryshime në Ligjin 81/2017 “për zonat e mbrojtura” si më poshtë:

Neni 58, pika 2 b, të shtohet: “përveç subjekteve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme që kanë kontrata afatgjate me Qeverinë Shqiptare”

Neni 73, pika 1, të saktësohet: “përjashtohen nga tarifat për zonat e mbrojtura subjektet që kryejnë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme që kanë kontrata afatgjatë me Qeverinë Shqiptare”

➤ Sygjerime për komisionin përgjegjës

Pas pyetjeve dhe diskutimeve Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi pas shqyrtimit të projektligjit i sygjeron Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin me cilësinë e komisionit përgjegjës sygjerime si më poshtë vijon:

- Neni 1 të pranohet duke shtuar parimin e përshtatshmërisë, parimin e kategorizimit sipas objektivave dhe parimin e fleksibilitetit të menaxhimit si parime të reja të mbrojtjes dhe adëimit të zonave të mbrojtura, bazuar në Udhërrëfyesin e IUCN-së, një nga dokumentet ndërkombëtare më prestigjioze për menaxhimin e zonave të mbrojtura, aderimi i RSH në të cilin u miratua nga Kuvendi në janar 2024.

Në kuadër të zbatimit të këtyre parimeve si dhe funksionit të diferencimit midis shkallëve të mbrojes së zonave të mbrojtura që aplikohen në nënzonat përkatëse, për të adresuar vullnetin e deputetëve propozues shtohet edhe përkufizimet: "Shkallë e dytë mbrotjeje", "zonë natyrore e pashqetësuar" dhe "zonë natyrore pak e shqetësuar.

- Neni 2 "Politikat mbi zonat e mbrojtura" të mos pranohet.
- Neni 3 "Funksioni i institucioneve publike" të mos pranohet.
- Neni 4 "Aksesi i publikut në zonat e mbrojtura" të mos pranohet.

Tre nenet më sipër vlerësohet se janë nene deklarative dhe nuk kanë vlerë të shtuar në përditësimin e politikave shtetërore për adëimin e zonave të mbrojtura. Në ligjin aktual janë të parashikuara kompetencat dhe funksionet e institucioneve shtetërore për mbrojtjen dhe

administrimin e zonave të mbrojtura, si dhe është i normuar edhe aktiviteti i vizitueshmërisë së zonave të mbrojtura.

Qëllimi që kanë pasur propozuesit për këto nene do të adresohet nëpërmjet shtimit të një neni (39/1) i cili krijon zyrat e administrimit të parqeve kombëtare (ZAPK), që do të kenë detyrën për të ruajtur, mbrojtur dhe administruar parqet kombëtare.

Këto do të jenë institucione tekniko-ligjore në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe në varësi teknike të AKZM-së.

- Neni 5 "Llojet e zonave të mbrojtura" të mos pranohet.

Sipas propozimit të deputetëve ai synon të përfshijë në llojin e zonave të mbrojtura edhe "zonat e mbrojtura me interes lokal/bashkiak. Vlerësohet se ky amendim është i panevojshëm pasi në klasifikimet e zonave të mbrojtura në ligjin aktual janë edhe parqet bashkiake.

- Neni 6 të mos pranohet.

Sipas propozimit të deputetëve bashkia administron jo më pak se 20% e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura që janë në territorin e saj.

Vlerësohet se ky nen fragmentarizon zonat e mbrojtura në Shqipëri, të cilat krijohen për të ruajtur vlerat natyrore me rëndësi kombëtare dhe/ose ndërkombëtare dhe për këtë arsye menaxhohen nga AKZM. Për zonat me rëndësi lokale të ruajes së vlerave natyrore, bashkitë mund të krijojnë dhe të menaxhojnë "Parqet bashkiake" ose "Kurorat e gjelbra", siç përcaktohet tashmë nga ligji ekzistues për zonat e mbrojtura.

Qëllimi i propozuesve për t'i ardhur në ndihmë bashkive do të arrihet nëpërmjet "dhënies me qira të kullotave" në zonat e mbrojtura për bagëtitë, në koordinim me pushtetin vendor. ADZM-ja apo ZAPK-ja lidhin një kontratë tripalëshe me bashkinë dhe subjektet e interesuara, nëpërmjet së cilës bashkia bëhet përfituese e të ardhurave që vijnë nga përdorimi i përkohshëm i kullotës. (teknikisht realizohet duke shtuar dy pika në nenin 40 të ligjit ekzistues)

- Neni 7 "Objektivat e shpalljes së territoreve si zona të mbrojtura" të pranohet duke u riformuluar me qëllim mirëpërcaktimin e objektivave, bazuar te parimi i zhvillimit të qëndrueshëm.
- Neni 8, të pranohet duke u riformuluar, pasi propozimi i deputetëve për këtë nen, i cili lidhet ngushtësisht me përfitimet e komunitetit lokal që jeton në zonat e mbrojtura, është i drejtë, por në formën e propozuar nuk reflekton kuadrin më të gjerë socio-ekonomik të këtij procesi.

Vlerësohet se ndryshimet e propozuara mbi shpalljen e zonës së mbrojtur nuk janë në përputhje me qëllimin që kërkohet të arrihet.

- Neni 9, të pranohet pasi shfuqizon nenin 13 të ligjit. Vlerësohet se është e rëndësishme të aplikohen rregullat e zonimit dhe nënzonimit dhe shkalla e mbrojtjes përkatëse në mënyrë që të kemi një ndarje të qartë të klasifikimit të zonave të mbrojtura, por edhe duke marrë parasysh nevojën për zhvillim të qëndrueshëm për komunitetin lokal dhe

zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Zonimi dhe nënzonimi nuk janë elemente thelbësore të procedurës së mbrojtjes së zonës së mbrojtur, por elemente tekniko - formale të kësaj procedure.

Për të përmirësuar kuptueshmërinë dhe zbatueshmërinë e dispozitave në fuqi mbi zonimin:

- shtohet përkufizimi i elementeve tekniko-formale të shpalljes së zonës së mbrojtur, në nenin (3) e përkufizimeve;

- shfuqizohet pika 2 e nenit 12, e cila pëcakton se për shpalljen e një zonë të mbrojtur mjedisore përcaktohen, paraprakisht, statusi i saj, kufijtë dhe zonimi i brendshëm, zona buferike rreth saj, adëata e ruajtjes së zonës dhe varësia e saj, mundësitë e përpunimit e të shfrytëzimit të zonës, të ardhurat që mund të krijohen dhe përdorimi i tyre në dobi të zonës;

- bëhen disa ndryshime ne kreun VI "Zonimi dhe Nënzonimi (neni 47,48,49,50)

- Neni 10 të pranohet duke e riformuluar, me qëllim reflektimin e problematikave si më poshtë:

- propozimin për liberalizimin e rregullave për ndërhyjet në Parkun Kombëtar cënon objektivat e mbrojtjes për të cilat shpallet një park kombëtar;

- përdorimi i termit të veprimtarive ekonomike duke mos e kufizuar atë në fusha veprimi apo aktivitete të caktuara jep miratim dhe për ndërtimin e hekurudhave, hidrocentraleve dhe sistemeve të naftës e të gazit me shtrirje të gjatë.

- Neni 11, i cili propozon Ndryshimet e nenit 17 të panohet. Ky ndryshim është i nevojshëm pasi parashikimi ligjor ekzistues nuk është në harmoni me udhëzuesin ndërkombëtar të IUCN për të shpallur një zonë të mbrojtur dhe nuk reflekton plotësisht kategorinë III për të cilën shpallet. Një monument natyre nuk mund të jetë i barabartë me Rezervën Strikte, kategoria I, pasi parimet dhe karakteristikat e shpalljes së tij janë tërësisht të ndryshme nga këto.

- Neni 12 të pranohet duke e riformuluar, me qëllim përshtatjen në teknikë legislative dhe logjike aplikimi me nenin 16 të ligjit nr.81/2017 që lidhet me kategorinë II, duke ruajtur karakteristikat e kategorisë IV. Kjo do të sjellë një zbatim të qartë të këtij neni në shpalljen e zonave të mbrojtura, përdorimin e aktit ligjor për secilin park natyror/ rezervat natyror të menaxhuar.

- Neni 13 të pranohet duke e riformuluar bazuar në parimet e IUCN-së. Ky nen propozon ndryshime në kategorinë V të mbrojtjes (neni 20 i ligjit) që është Peizazhi i Mbrojtur, duke lejuar ndërhyrjet urbane, të rekreacionit dhe industriale si si dhe zhvillimin e aktiviteteve me fokus zhvillimin ekonomik të zonës.

- Neni 14 të mos pranohet pasi amendimi i nenit 21 të ligjit në fuqi vlerësohet si i panevojshëm, pasi planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi hartohen nga AKZM-ja dhe miratohen nga ëi përgjegjës për zonat e mbrojtura. Secila zonë mbrojtur në Republikën e Shqipërisë duhet të ketë aktin ligjor të dedikuar.

- Neni 15, 16 dhe 17 të pranohen duke i riformuluar pasi këto nene propozojnë një qasje të unifikuar të përcaktimit të veprimtarive duke lënë një liri propozimi dhe veprimi në planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura, përveç atyre të përcaktuara në nenet 33 dhe 34. Planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi hartohen nga AKZM-ja dhe miratohen nga ëi përgjegjë për zonat e mbrojtura.
- Neni 18 të pranohet duke e riformuluar pasi ky nen propozon shtesa të veprimtarive të lejuara. Me qëllim për të pasur qartësi në veprimtaritë e lejuara ex lege, ka nevojë të riformulohet i gjithi në frymën e propozimit integral të të gjitha neneve të projektligjit.
- Neni 19 dhe 20 të mos pranohen, pasi këto nene konsistojnë në krijimin e mundësive për rishikimin e planit të menaxhimit nga AKZM-ja, mbështetur në parimin e përshtatshmërisë dhe nevojës për rishikimin e planit të menaxhimit.

Adresimi i këtyre rregullimeve duhet të gjejë garanci më të plotë me ndryshime në disa nene të tjera në tekstin e ligjit nr. 81/2017 (nenet 56,57,66, 67 dhe 69).

- Neni 21 të pranohet duke e riformuluar bazuar në aktet nënligjore që do të dalin në përfundim të miratimeve të komisionit përgjegjës.

Pra, sa më sipër, meqënëse ndryshimet në projektligjin e propozuar janë të shumta, numri i neneve që nuk pranohen dhe i atyre që shtohen është i konsiderueshëm, sugjerojmë që në aspekt të anës formale nga komisioni përgjegjës të hartohet një variant integral i projektligjit.

➤ **Përfundime**

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se:

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit; dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm e miratoi atë dhe u shpreh dakord për t'ia përcjellë mendimin Komisionit përgjegjës dhe për votim në seancë plenare.

RELATOR

Jurgis ÇYRBJA

KRYETARI

Klotilda BUSHKA